



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:148105

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05827143

K.DH.SH.II.nr.65/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, në çështjen përmbartimore të kreditorit, “Kreis Group” me pronar N.M. me NUI811380154 me seli ne Gjilan, te cilin e përfaqëson sipas autorizimit Albesjana Rexhepi-Uka avokate nga Gjilani, ndaj debitorit “Lidhja Demokratike e Kosovës” - Dega ne Gjilan, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles e Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1812/22 dt.19.09.2023, me datën 14.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit “Kreis Group” me pronar N.M. me NUI811380154 me seli ne Gjilan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1812/22 dt.19.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles e Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1812/22 dt.19.09.2023, ka pranuar prapësimin e debitorit “Lidhja Demokratike e Kosovës” - Dega ne Gjilan dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.295/22 dt.27.05.2022, te lejuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Sh.Arifi me seli ne Gjilan si dhe ka përfunduar procedurën ne këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak te zbatimit te gabuar te dispozitave te procedurës përmbartimore, zbatimit e gabuar te se drejtës materiale dhe vërtetimit te gabuar ose jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë këtë ankesë ta aprovoj ndërsa aktvendimin e atakuar ta ndryshoj.

Dhoma e Shkalles e Dytë, i shqyrtoi shkresat e LPP, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Kreis Group” me NUI811380154 me seli ne Gjilan, me datën 27.05.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “Lidhja Demokratike e Kosovës” - Dega ne Gjilan, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.12-14 dt.03.06.2014 dhe nr.41-11-17 dt.08.11.2017. Përmbartuesi Privat Sefer Sh.Arifi nga Gjilani, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.295/22 dt.27.05.2022, ka lejuar përmbartimin, me te cilin detyrohet debitori qe ne emër te borxhit nga faturat kreditorit t’ia paguaj detyrimin ne vlerën prej 2,994.80 euro si dhe shpenzimet e përmbartimit, ne afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit te urdhrit përmbartimor.

Kundër urdhrin për përmbartim, debitori me datën 13.07.2022 ka ushtuar prapësim, përmes te cilit pretendon se fatura mbi te cilën është mbështetur propozimi për përmbartim nuk është titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare te përmbartueshmërisë, shton se borxhi i pretenduar nga kreditori është parashkruar ne kuptim te nenit 355 te LMD, i referohet edhe nenit 38 par.1 dhe 2 te LPP sepse propozimi për përmbartim nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e biznesit, ndërsa organi përmbartues nuk ka vepruar ne pajtim me nenin 102 te LPK ne mënyrë qe ta korrigjoj ose plotësoj propozimin. Propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbartimor ta shfuqizoj dhe kreditorin ta obligoj te paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit ka paraqitur kreditori me datën 18.07.2022, me arsyetimin se pretendimet e debitorit janë te pabazuara, faturat janë dokument i besueshëm nga neni 29 par.1 pika 3 e LPP dhe se pretendimi se propozimi është marrë ne kundërshtim me nenin 38 te LPP nuk qëndron sepse Partitë Politike janë forma te veçanta te organizimit social te cilat nuk duhet te ngatërrohen me asociacione e as me klube tjera shoqërore dhe si te tilla nuk kanë numër identifikues siç ka pretenduar debitori. Sa i përket pretendimit te debitori se është parashkruar detyrimi ndaj kreditorit nuk qëndron sepse kreditori ne mënyrë te vazhdueshme ka kërkuar borxhin, propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimor ta lë ne fuqi ndërsa te obligohet debitori te paguaj shpenzimet për përpilim te përgjigjes ne prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles se parë, pas shqyrtimit te prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka marrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1812/22 dt.19.09.2023, me të cilin e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin për përmbartim, duke vendosuri decidivishte si ne dispozitiv te aktvendimi, me arsyetimin se pas analizimit te provave ne lende dhe pretendimeve te palëve ka gjetur se prapësimi i debitori është i bazuar e kjo marrë parasysh nenin 355 te LMD, andaj konsideron se borxhi prej 2,994.80 euro qe rrjedh nga faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbartimi është parashkruar sepse ka kaluar afati prej 3

vjetësh kur kreditori ka pasur mundësi me paraqitë kërkesën e tij dhe marrë për bazë faktin se propozimi për përmbarim është iniciuar me datën 27.05.2022, prandaj mbi këtë arsye dhe konform nenit 73 dhe nenit 13 par.1 dhe 1.2 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale vendosi si në dispozicion të aktvendimit të saj.

Dhoma e Shkalles e Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozitë konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Po ashtu vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar ka konstatuar drejt faktin se borxhi nga faturat nr.12-14 dt.03.06.2014 dhe nr.41-11-17 dt.08.11.2017 dt.27.10.2017 në bazë të cilave Organi Përmbarues ka lejuar përmbarimin është parashkruar dhe kjo bazuar në nenin 355 par.1 të LMD, i cili thotë “*Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite*”. Ndërsa par.2. thotë “*Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer*”, pra në rastin konkret ka kaluar periudha me tepër se tre vite e paraparë me dispozitë ligjore. Kjo gjykatë analizoi pretendimin e kreditorit se disa here ka kërkuar borxhin e tij çka ka biseduar edhe me zyrtar të debitorit, por një pretendim i tillë nuk qëndron pasi bazuar në shkresat e lëndës rezulton se edhe parashtrësja e emërtuar si *Letër Kujtese* drejtuar debitorit nga kreditori me datën 10.05.2022 përmes së cilës kërkon nga debitori përmbushjen e detyrimit del se është bërë jashtë afatit ligjor prej tre vitesh.

Andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se marrë parasysh datat e faturave detyrimi nga të cilat kërkohet të përmbushët dhe datën e paraqitjes së propozimit për përmbarim del se borxhi nga faturat është parashkruar, ashtu që edhe kjo gjykatë e pranon përfundimin juridik të gjykatës së shkalles së parë mbështetur edhe në nenin 71 par.1 nenpar.1.4 të LPP i cili parashihet që “*ka skaduar afati kohor brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohet përmbarimi*”. Kjo gjykatë analizoi edhe pretendimet ankimore të kreditorit dhe vlerësoi se njëjtat janë irelevante për një vendosje ndryshe ashtu që të njëjtat i refuzon ndërsa aktvendimin e shkalles së parë e vërteton.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles e Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitivin e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.65/24, me datë 14.06.2024

Gjyqtari
Ramush Bardiqi